



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 3/201
Date: 28/9/2022

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur më 26.9.2022, mori

V E N D I M

Për vazhdimin e kohëzgjatjes së afatit për përfundimin e studimeve për studentët e nivelit të studimeve baçelor, master dhe doktoratë, të cilët e kanë kaluar periudhën e lejuar të kohëzgjatjes së rregullt të studimeve, sipas kushteve në vijim:

- I. Studentëve të nivelit baçelor me sistem tre (3) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2014/2015, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve, kanë dëgjuar ligjëratat e vitit të fundit, si dhe kanë përfunduar të gjitha provimet e dy (2) viteve paraprake, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më 30.9.2023.
- II. Studentëve të nivelit baçelor me sistem tre (3) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit akademik 2014/2015, dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet në programet që përfundojnë me mbrojtje të punimit të temës së diplomës, u vazhdohet periudha e diplomimit, respektivisht mbrojtjes së punimit të temës së diplomës deri më 30.9.2023, ndërsa në programet që studimet përfundojnë pa punim të diplomës dhe nuk kanë më shumë se dy provime të vitit të fundit, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më 30.9.2023.
- III. Studentëve të nivelit baçelor me sistem katër (4) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2012/2013, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve, kanë dëgjuar ligjëratat e vitit të fundit, si dhe kanë përfunduar të gjitha provimet e tri (3) viteve paraprake, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më 30.9.2023.
- IV. Studentëve të nivelit baçelor me sistem katër (4) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit akademik 2012/2013 dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet në programet ku studimet përfundojnë me mbrojtje të temës së punimit të diplomës, u vazhdohet periudha e diplomimit, respektivisht mbrojtjes së temës së punimit të diplomës deri më 30.9.2023, ndërsa në programet ku studimet përfundojnë pa punim të diplomës dhe nuk kanë më shumë se dy provime të vitit të fundit, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më 30.9.2023.
- V. Studentëve të nivelit baçelor me sistem pesë (5) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2010/11, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së studimeve të rregullta, kanë dëgjuar ligjëratat e vitit të fundit të studimeve, si dhe kanë përfunduar të gjitha provimet e katër (4) viteve paraprake të studimeve, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më 30.9.2023.

- VI. Studentëve të nivelit baçelor me sistem pesë (5) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit 2010/2011 dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet në programet ku studimet përfundojnë me mbrojtje të temës së punimit të diplomës, u vazhdohet periodha e diplomimit, respektivisht mbrojtjes së temës së punimit të diplomës deri më 30.9.2023, ndërsa në programet ku studimet përfundojnë pa temë të punimit të diplomës dhe nuk kanë më shumë se dy provime të vitit të fundit, u vazhdohet periodha e përfundimit të studimeve deri më 30.9.2023.
- VII. Studentëve të nivelit master me sistem një (1) vjeçar të studimeve, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2018/2019, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve dhe kanë dhënë 50% të provimeve të parapara, si dhe kanë paraqitur ndonjë provim gjatë vitit akademik 2021/2022, pa marrë parasysh rezultatet, u vazhdohet periodha e përfundimit të studimeve deri më 30.9.2023.
- VIII. Studentëve të nivelit master me sistem një (1) vjeçar të studimeve, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit akademik 2018/2019 dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet, u vazhdohet periodha e diplomimit, respektivisht mbrojtjes së temës së diplomës deri më 30.9.2023.
- IX. Studentët e nivelit master me sistem dy (2) vjeçar të studimeve, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2016/2017, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve dhe nëse kanë përfunduar provimet e vitit të parë, si dhe kanë paraqitur ndonjë provim gjatë vitit 2021/2022, pa marrë parasysh rezultatet, u vazhdohet periodha e përfundimit të studimeve deri më 30.9.2023.
- X. Studentëve të nivelit master me sistem dy (2) vjeçar të studimeve, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit akademik 2016/2017 dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet, u vazhdohet periodha e diplomimit, respektivisht mbrojtjes së temës së diplomës deri më 30.9.2023.
- XI. Studentëve të nivelit baçelor dhe master që kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve, kanë dëgjuar ligjëratat e vitit të fundit, mirëpo nuk i kanë përfunduar të gjitha provimet e parapara në programet në të cilat studimet përfundojnë me mbrojtje të temës së punimit të diplomës, ndërsa fakulteti përkatës nuk i ofron këto studime me programe të reja studimore, u vazhdohet periodha e përfundimit të studimeve deri në afatin e qershorit 2023. Provimet për këtë kategori të studentëve do të organizohen nga mësimdhënësit e lëndëve përkatëse, respektivisht nga komisionet e fushave përkatëse në përbërje prej tre (3) anëtarëve. Kërkesat për vazhdim të afatit të përfundimit të studimeve pas afatit të përcaktuar si në këtë paragraf, nuk do të merren në shqyrtim.
- XII. Studentëve të cilëve në vitin akademik 2021/2022, u është lejuar vazhdimi i kohëzgjatjes së afatit për përfundimin e studimeve sipas parimit të pikës XI të këtij vendimi, respektivisht deri në afatin e qershorit 2022, nuk ju lejohet afat tjetër shtesë.
- XIII. Studentëve të tjerë të nivelit të studimeve baçelor dhe master të cilët e kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së studimeve të rregullta për vit studimi, ndërsa aktualisht janë në vitin e parë (I), dytë (II), tretë (III), katër (IV) apo pestë (V), por që nuk kanë përfunduar provimet sipas kushteve të përcaktuara në pikat I deri X të këtij vendimi, u mundësohet vazhdimi i

studimeve sipas plan-programit të ri të studimeve pa pasur nevojë aplikimi përmes konkursit publik.

- XIV. Studentët e nivelit të doktoratës të cilët kanë tejkaluar afatin e kohëzgjatjes së studimeve të përcaktuar sipas rregullores në fuqi në kohën e regjistrimit të studimeve, u vazhdohet periudha e mbrojtjes së punimit të doktoratës deri më 30.9.2023.
- XV. Periudha e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt në bazë të nenit 152 të Statutit nuk llogaritet në kohëzgjatjen e studimeve.
- XVI. Njësitë akademike obligohen që këtë vendim ta publikojnë në tabelat e shpalljeve në njësitë përkatëse akademike.
- XVII. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi me nr. prot. 1/482, datë 6.9.2021.
- XVIII. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi janë menaxhmenti dhe shërbimet për studentë në njësitë përkatëse akademike të UP-së.
- XIX. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat dhe vlen për vitin akademik 2022/2023.
- XX. Pas përfundimit të vitit akademik 2022/2023, respektivisht pas datës 30.9.2023, nuk lejohet vazhdim i kohëzgjatjes së afatit për përfundimin e studimeve për kategoritë e studentëve në kuptim të dispozitave të këtij vendimi dhe kërkesat nuk do të merren në shqyrtim.
- XXI. Universiteti/njësitë akademike do t'i informojnë studentët e prekur nga ky vendim nëpërmjet publikimit të tij në uebfaqet e UP-së, si dhe publikimit në tabelat e shpalljeve dhe në uebfaqet e njësive akademike përkatëse.

Arsyetim

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur më 26.9.2022, ka diskutuar lidhur me lejimin dhe përcaktimin e kushteve për vazhdimin e kohëzgjatjes së afatit për përfundimin e studimeve për studentët e nivelit të studimeve baçelor, master dhe doktoratë, të cilët e kanë kaluar periudhën e lejuar të kohëzgjatjes së rregullt të studimeve, në vitin akademik 2022/2023. Senati, duke marrë parasysh rrethanat e jashtëzakonshme nën kushtet e pandemisë, rrethanat tjera objektive, vonesat në trajtimin e kërkesave të kandidatëve për lejim të temave të punimit të diplomës dhe mentorimeve, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Menaxhmentit të UP-së;
3. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
4. Dekanëve të njësive akademike;
5. Sekretarëve të njësive akademike;
6. Zyrës për çështje akademike;
7. Zyrës për çështje të studentëve.



Kryesues i Senatit të UP-së:

Prof. dr. Naser Sahiti, rektor